REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 352, Datë 12.11.2026

MBI

REGJISTRIMIN E IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "EU GREEN ENERGY" SH.P.K. TË LIDHUR ME CENTRALIN FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 51 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; nenit 6 të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.08.2026; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2346/5 prot., datë 10.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "EU GREEN ENERGY" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

- Shoqëria "EU GREEN ENERGY" sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 563, Seria T23, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 246 , datë 09.08.2023, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2346 prot., datë 29.07.2026, shoqëria ka depozituar kërkesën për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 2346/1 prot., datë 14.10.2026, ERE i kërkoi shoqërisë të depozitojë të plotësuar Formularin e Regjistrimit, së bashku me dokumentacionin shoqërues, sikurse përcaktuar në "*Rregullat për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar"*, miratuar me vendimin nr. 230, datë 18.08.2026.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2346/2 prot., datë 22.10.2026, shoqëria ka depozituar formularin e plotësuar dhe dokumentacion bashkëlidhur.
- Në vijim, në përgjigje të e-mailit të ERE-s, të datës 04.11.2026, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2346/4 prot., datë 09.11.2026, shoqëria ka depozituar dhe Planin e Biznesit dhe Mënyrën e financimit të projektit.
- Rezulton se kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" dhe të "*Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230/2026. Shoqëria "EU GREEN ENERGY" sh.p.k. ka paraqitur formularin e plotësuar, dokumentacionin teknik dhe atë financiar për regjistrimin e

impiantit të depozitimit të energjisë elektrike "Kulluricë", me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 100 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 400 MWh.

- Për sa më sipër, vlerësohet se plotësohen kushtet për vijimin e procedurës së regjistrimit të këtij impianti në kuadër të licencës nr. 563, Seria T23, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 246, datë 09.08.2023, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Përsa i përket pikës së lidhjes me rrjetin, shoqëria ka depozituar në ERE shkresën nr. 213 prot., datë 18.12.2025, drejtuar "Operatorit të Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a., për marrjen e një opinioni paraprak për lidhjen me rrjetin e transmetimit të këtij sistemi depozitimi. Në këto kushte, vlerësohet se shoqëria duhet të ndjekë procedurat përkatëse pranë OST-së për sigurimin e pikës së lidhjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat teknike të operatorit.
- Shoqëria i nënshtrohet regjimit kalimtar të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026, për një periudhë jo më shumë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit. Për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike pas përfundimit të këtij afati, shoqëria duhet të ndjekë procedurën përkatëse të licencimit ose të modifikimit të licencës ekzistuese, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.
- Për këtë vendimmarrje vlerësohet që të njoftohen dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe shoqëria "Operatorit të Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të regjistrojë impiantin e depozitimit të energjisë elektrike "Kulluricë", të deklaruar nga shoqëria "EU GREEN ENERGY" sh.p.k., me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 100 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 400 MWh, në kuadër të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike (BESS), i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, njihet dhe lejohet të vijojë operimin për periudhën kalimtare të përcaktuar në nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike".

3. Për operimin e impiantit të depozitimit pas datës 14.07.2027, shoqëria duhet të aplikojë për licencën përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Çdo ndryshim në të dhënat e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike duhet të njoftohet nga shoqëria në ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës të marrë masat për regjistrimin dhe pasqyrimin e të dhënave të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në Regjistrin përkatës të ERE-s dhe në Fletën individuale të regjistrimit, në përputhje me

rregullat në fuqi, përfshirë çdo ndryshim të këtyre të dhënave të njoftuar nga shoqëria sipas pikës 4 të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "EU GREEN ENERGY" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI